



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I M B L E D H J E S S O L E M N E T Ë K U V E N D I T T Ë R E P U B L I K Ë S S Ë K O S O V Ë S ,
E M B A J T U R M Ë 1 2 Q E R S H O R 2 0 2 0**

**S A S V E Č A N E S E D N I C E S K U P Š T I N E R E P U B L I K E K O S O V A ,
O D R Ž A N E 1 2 . J U N A 2 0 2 0 . G O D I N E**

**Q E R S H O R - J U N
2 0 2 0**

Rendi i ditës

1. Shënimi i 12 Qershorit - Dita e Paqes

Dnevni red

2. Obeležavanje 12. Juna - Dana mira

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

KRYETARJA: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Mirë se keni ardhur në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës me rastin e shënimit të 12 Qershorit, Dita e Paqes, që e shënon ditën e çlirimit të Republikës sonë!

Ju ftoj të ngrihemi në këmbë për intonimin e Himnit të Republikës së Kosovës.

(Himni i Republikës së Kosovës)

Të nderuar deputetë,
Për shkak të kushteve të pandemisë, siç e dini, ka qenë e pamundur që miqtë tanë të shumtë, të cilët zakonisht marrin pjesë në seancat tona solemne, të jenë sot me ne.

I përshëndesim që të gjithë! I falënderojmë që gjithnjë kanë qenë pranë nesh dhe i lusim për mirëkuptimin e Kuvendit të Republikës, që sot për shkak të mungesës së kushteve të sallës ka qenë e pamundur t'i ftojmë.

Megjithatë, ne në fillim do të përcjellim një video të dërguar nga forcat e NATO-s në Kosovë lidhur me rolin e tyre në shtetin tonë që nga viti 1999.

(Transmetim i videos)

I falënderojmë sërish, që po festojnë sot bashkë me ne dhe me popullin e Kosovës për të arriturat tona këto 20 vjet!

Të nderuar të pranishëm,
Më lejoni që me rastin e shënimit të shënimit të 12 Qershorit - Ditës së Çlirimit tonë të ju drejtohem me një fjalë rasti.

* * *

VJOSA SADRIU - OSMANI: Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar!

Ndihem tepër e nderuar që mund t'ju drejtohem sot nga foltorja e tempullit të demokracisë, Kuvendit të Republikës, dhe t'ju përcjell urimet më të mira me rastin e 12 Qershorit, ditës së lirisë dhe çlirimit të shtetit tonë të dashur, Republikës së Kosovës për të gjithë qytetarët, pa dallim.

Shkaku i rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19 dhe duke i respektuar rekomandimet e institucioneve shëndetësore për respektim të distancës fizike, na është pamundësuar që kjo seancë solemne të mbahet me mysafirë të ftuar, të shumtë, të cilët i janë gjetur vendit tonë në ditët më të vështira dhe të cilët do ta madhështonin këtë solemnitet.

Pjesëtarët e trupave paqeruajtëse të NATO-s sot nuk janë me ne në këtë sallë, por festojnë me ne dhe duhet ta themi sërish që kanë bërë shumë që ne sot të jemi këtu, të ndihemi të lirë, të jetojmë të lirë dhe ta ndërtojmë gradualisht Kosovën që e duam ne, në një shtet ku sundon rendi e ligji, ku garantohet siguria humane dhe fizike në çdo cep të vendit dhe ku shteti, mbi të gjitha, është në shërbim të mirëqenies së qytetarëve të vet.

Të dashur qytetarë!

Si sot, 21 vjet më parë, u realizua përfundimisht ëndrra dhe përkushtimi i brezave të tërë, të cilët, jo vetëm që e ëndërruan lirinë, por edhe luftuan për të, të bindur se politikat shfarosëse dhe dhuna e regjimeve nuk mund ta shuajnë kurrë vullnetin e një populli për të jetuar i lirë e i mosvarmë.

Atë ditë në Kosovë zbankuan trupat e parë të Aleancës më të fuqishme në histori të njerëzimit - trupat e NATO-s. Pas 78 ditë bombardimesh të caqeve ushtarake jugosllave dhe të policisë serbe, shpresa ngadhënjeu. Kosova e pa dritën e lirisë, teksa qytetarët e saj morën frymë, e përjetuan atë që njihet si ditë e lirisë, apo ditë e çlirimit.

Hyrjes së trupave të NATO-s i parapriu Marrëveshja e Kumanovës e 9 qershorit, e cila i dha fund pranisë së regjimit jugosllav e serb në Kosovë. E, me hyrjen e NATO-s në Kosovë u rilidh aleanca jonë me popujt e lirë, aleancë të cilën ne e kemi dëshmuar së paku në tri momente jetike në historinë e popullit tonë, momente që e kanë shënuar, jo vetëm ekzistencën tonë, por edhe identitetin tonë properëndimor, të cilit i përkasim qysh në krye të herës: projekti integrues i Skënderbeut, Lidhja e Prizrenit, 142-vjetorin e së cilës e festuam dy ditë më parë, si dhe projekti ynë nacional-kulturor i bashkimit të të gjithë shqiptarëve gjatë viteve të '90-ta.

Projekti i parë, ai i Skënderbeut, e krijoi aleancën e përbashkët me qytetërimin perëndimor, duke e mbrojtur atë në portën hyrëse të saj, në Arbëri. Lidhja e Prizrenit e ridëshmoi përkatësinë tonë

kombëtare, e sensibilizoi nevojën e rizgjimit kombëtar karshi copëtimit të tokave shqiptare dhe depërtimit nga trojet tona stërgjyshore. Lëvizja për pavarësi e viteve të '90-ta e vulosi përfundimisht orientimin tonë properëndimor dhe krijimin e miqësive dhe aleancave. Pra, kjo ishte nismëtare e ndryshimit idelologjik në Ballkanin e trazuar dhe të stërkequr nga sistemi komunist, duke e sforcuar identitetin tonë politik e historik dhe duke e bërë të mundur jetësimin e shtetit të Kosovës.

E krijoi solidaritetin e thellë e të papërsëritshëm në mes qytetarëve të këtij vendi dhe e ringjalli frymën e lirisë, e cila, duke u ripërtërirë, ka mbijetuar gjithmonë në shpirtin tonë. Përfundimisht, u dëshmuua në Kosovë, më shumë se kudo tjetër në botë, se liria e jashtme mund të vijë vetëm nëse e fitojmë lirinë tonë të brendshme. Se, siç thoshte modeli filozofik Presidentit Historik, Dr. Rugovës, Pjetër Bogdani, “në mundime ta shpalosim guximin, në rreziqe ta ruajmë besimin, ndërsa në turbullira të veprojmë me qetësi”. Prandaj, ne u çliruam, edhe sepse e fituam lirinë e brendshme, sepse guxuam të ëndërrojmë e të luftojmë për liri, sepse e ruajtëm besimin dhe sepse, mbi të gjitha, këmbëngulëm në vlerat humane kur fqinjët tanë veriorë i shkelnin ato.

Aleancat historike të ndërtuara ndër vite ishin bazë e fortë që në orët e liga, nëpër të cilat kaloi Kosova, të luajnë rol, jo vetëm historik, por edhe ta rinisin jetën. Këto aleanca na shpëtuan nga zhbërja, prandaj sot jemi këtu në këtë përvjetor edhe falë tyre dhe u përulemi me pietet.

Rrugëtimi ynë nuk do të përmbylej kurrë pa përkushtimin e miqve tanë të shumtë gjithandej globit, të cilët lëvizja i krijoi dhe i ruajti me përkushtim. Të cilët populli i Kosovës në çdo cep të saj i ndërtoi e i ruan edhe sot. Ai nuk do të ishte i mundur sikur presidenti i SHBA-ve në atë kohë, presidenti Bill Clinton, të mos e dëgjonte lutjen e Nënë Terezës që ta ndihmonte dhe ta ruante popullin e saj shqiptar; pa përkushtimin e vetë Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj parimeve të lirisë dhe pa këmbënguljen e miqve tanë në Kongres dhe në Senat, por edhe të gjitha administratave, edhe të demokratëve, edhe të republikanëve, përfshirë presidentin Bush dhe presidentët e tjerë që erdhën pas tij. Kosova do të këtë respekt e mirënjohje të pafund edhe për Sekretaren e Shtetit, znj. Medeleine Albright, si dhe këmbënguljen e kryeministrit Blair, për këmbënguljen dhe ndihmën e kancelarit Shroeder, të presidentit Shirak, të kryeministrit Massimo D'alema, të sekretarit gjeneral të NATO-s Javier Solana, dhe gjeneralin e NATO-s në atë kohë, Wesley Clark. Por, edhe për shumë e shumë emra të tjerë që na u gjendën në kohët më të rënda.

Ne do t'u jemi përjetësisht mirënjohës atyre për rreshtimin e tyre në krah të popullit të Kosovës në një moment të rëndë historik, kur shfarosja dhe dëbimi ishin bërë projekt hegjemonist, të cilin po kujdesej ta realizonte regjimi gjencidal i Milosheviqit. Për një rrezik të tillë kanë folur edhe dy sekretarë të përgjithshëm të NATO-s, sekretari Stoltenberg, si dhe së fundi edhe zëvendëssekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoana. Që të dy konfirmuan që NATO-ja intervenoi në Kosovë për ta parandaluar gjencidin.

Kjo përkrahje tashmë është shndërruar në miqësi të përhershme, të cilën ne do ta kultivojmë më tej e ta ruajmë, ashtu siç na mësuam paraardhësit tanë. Sepse, është në traditën tonë që miqësitë t'i krijojmë e t'i ruajmë.

Por, kur e kujtojmë 12 qershorin e '99-tës, ne nuk mund të mos e kthejmë vëmendjen në përpjekjet e pafundme të gjeneratave të tëra, të bijve dhe bijave të këtij vendi, të cilët, të bindur fort se liria është e arritshme, nuk pushuan kurrë së punuari e luftuari për të. Në këtë ditë, ne e kujtojmë Dr. Ibrahim Rugovën, ikonën e përbashkët të lirisë, njeriun e dijeve, liderin shpirtëror të shqiptarëve, njeriun për të cilin ish-kryeministri britanik, z. Tony Blair, mes tjerash, kishte thënë: “Më 1998, ai erdhi në një vizitë në Downings Street. Ishte një person i heshtur dhe modest. Deri sa po dilte, më tha: “Të lutem, një gjë të vetme ta kërkoj. Mos lejo që njerëzit e mi të vuajnë më. Ndiej për ata atë që do të kishe ndjerë për popullin tënd dhe ndihmo”. I thashë se Britania do të ndihmonte. Ia dhashë besën time Rugovës, fjalën e nderit, dhe e mbajta, e çlirua Kosovën”.

Sot i kujtojmë sot me pietet e me nderimet më të larta heronjtë tanë, të cilët lirinë e vendit e patën ideal jetësor. E kujtojmë komandantin legjendar të Ushtrisë Çlirimtare, Adem Jasharin, gjithë Familjen Jashari, e cila dha gjithçka për Kosovën. Dhanë gjithçka dhe u sakrifikuan për lirinë e vendit dëshmorët e heronjtë e këtij vendi, dhe njëkohësisht i kujtojmë me dhimbje edhe mbi 1 600 të pagjeturit tanë, bijtë e nënë Ferdonijes e të shumë nënave të tjera, i kemi në vëmendje vuajtjet e grave që i mbijetuan dhunës seksuale gjatë luftës, i kujtojmë martirët e shumtë, përfshirë gratë, fëmijët e pleqtë, si dhe të gjithë njerëzit e mirë të këtij vendi, të cilët sakrifikuan çdo gjë për lirinë e vendit të tyre.

Në këtë ditë të veçantë e nderojmë edhe gjeneratën e deputetëve të këtij kuvendi, të cilët më 1990 e shpallën Deklaratën e Pavarësisë si akt themeltar të shtetit të Kosovës dhe, më pas, Kushtetutën e parë të vendit, atë të Kaçanikut; si vullnet qytetar, i shprehur me Deklaratën e shpalljes së pavarësisë së vendit. I falënderojmë të gjitha ato gra dhe burra që e jetësuan këtë vullnet me Deklaratën e Pavarësisë të vitit 2008.

Të dashur qytetarë!

Ne e njohim mirë peshën e lirisë, sepse e kemi përjetuar për shekuj të tërë mungesën e saj. Por, po kështu, ne mund të dëshmojmë se sa e madhe është vlera e saj dhe i rëndë çmimi që kemi paguar. Pavarësia e Kosovës e ka vulosur fatin dhe lirinë e popujve në Ballkan. E ne, qytetarët e Republikës së Kosovës, e kuptojmë se çfarë do të thotë të rritesh nën një regjim shtypës, në të cilin rrënjët etnike janë argument i mjaftueshëm për të qenë i shtypur e i vrarë; ne e kemi përjetuar këtë dhe mund të dëshmojmë për të. Historinë e kemi në krah. Kosova e ka numrin më të madh të fëmijëve të vrarë e të masakruar në raport me numrin e banorëve krahasuar me të gjitha luftërat në territorin e ish-Jugosllavisë. Prandaj, dua që sot ta kthejmë vëmendjen

veçanërisht kah këta 1 133 fëmijë, shumë prej tyre foshnje vetëm disajavëshe ose disamuajshe, edhe dyvjeçare, fëmijë të vegjël, të cilët u vranë sepse ai regjim nuk e kursente askënd.

Në këtë Ditë të Lirisë, nga kryeqyteti i shtetit të Kosovës e kemi vetëm një mesazh. Siç ishim dikur unik për lirinë si një akt sublim, sot duhet të jemi unik në idenë për paqe të qëndrueshme, duke e mbrojtur sovranitetin e shtetit tonë në çdo pëllëmbë të territorit të tij. Ne jemi të gatshëm ta kultivojmë paqen e stabilitetin rajonal, siç kemi bërë gjithnjë. Kjo ishte edhe porosia e presidentit Klinton në vitin e tij të parë në Ferizaj pas luftës, kur tha: “Ne e fituam luftën, por tash është koha që ju ta ndërtoni paqen”.

Por, zonja dhe zotërinj, ne nuk do të mund të arrijmë në këtë pikë, nëse nuk i kujtojmë të gjithë ata që sakrifikuuan për këtë ditë, posaçërisht këta 1 133 fëmijë e vranë e të zhdukur gjatë luftës. Ata do të jenë peng yni edhe për aq kohë sa nuk do të mund të zbardhet fati i secilit fëmijë të zhdukur dhe derisa aktorët e këtyre vrasjeve e masakrave nuk do të përballen me drejtësinë.

Sot i kujtojmë të gjithë në zemrat e mendjet tona. Më lejoni të ndaj vetëm disa nga storiet e ëndrrat e tyre.

E kujtojmë Burimin, i cili u vra kur ishte vetëm 12 vjeç. Ai e kishte pasion recitimin e leximin, aq sa në oborr e ruante abetaren dhe fletoren, në rast se shtëpia i digjej, apo në rast se do dëboheshin.

I kujtojmë fëmijët e familjes Muçolli të Poklekut të Vjetër, të cilët më 17 prill 1999 u masakruan e u vranë, e më pastaj u dogjën kufomat e tyre.

I kujtojmë fëmijët e familjes Deliu nga Abria e Epërme, të cilët, një ditë pasi u strehuan në mal, të gjithë e gjetën vdekjen në mënyrën më mizore më 26 shtator 1998.

E kujtojmë Hajriun 12-vjeçar që donte të bëhej polic për t’i mbrojtur të tjerët dhe jo për t’i vranë e dëbuar, vëllain e tij Agonin e motrën Dardanen që donin të bëheshin mjekë. Më 12 qershor 1999, në Pejë, në mbrëmje, gjersa ishin në gjumë, një breshëri plumbash automatikësh dhe granatash ua ndërpreu atyre ëndrrat e tyre përgjithmonë.

I kujtojmë fëmijët e vranë të familjes Berisha në Suharekë. I kujtojmë të gjitha ata fëmijë të rënë në çdo cep të Kosovës.

I kujtojmë fëmijët e rënë të Familjes Legjendare Jashari.

Por, po ashtu i kujtojmë Anitën, Lirien, Çlirimtarin, Arianitin e të gjithë fëmijët, të cilëve iu ndërpre jeta në njëmujorin e parë.

I kujtojmë fëmijët e vrarë në bodrumin e shtëpisë së familjes Vejsa në Gjakovë.

E kujtojmë edhe Dafinën, foshnjën 6-muajshe, të cilën forcat serbe e ekzekutuan në kraharonin e nënës dhe ajo ishte e pagjetur deri para pak vitesh, kur u rivarros nga prindërit dhe familja.

E kujtojmë secilin fëmijë që u shndërrua në lule të lirisë.

Dhe, po ashtu nënën shtatzënë Lirien, e cila e barti barrën e së ardhmes së Kosovës në trupin e saj dhe e skaliti të ardhmen e vendit me emrin e saj. Ajo nuk arriti t'i jepte jetë foshnjës së saj, sepse atë ia ndërpreu regjimi gjenocidal serb, por arriti t'i jepte jetë dhe kuptim shtetit të ardhshëm të fëmijëve të tjerë.

Sot shkëputa vetëm disa emra e disa rrëfime nga mijëra e mijëra familje që kanë dhënë më të shtrenjtit e tyre, por le të sigurohemi së bashku që emrat, rrëfimet dhe ëndrrat edhe të fëmijëve të tjerë të vrarë të dëgjohen e të tregohen, sepse është më e pakta që ua kemi borxh atyre.

Për ta jetësuar këtë kujtim, i propozoj Kuvendit të Kosovës që me mirëkuptimin e deputetëve të Republikës dhe në përputhje me procedurat e përbashkëta që i kemi, njëren nga ulëset në qendër të sallës ta mbajmë të rezervuar si dedikim fëmijëve të pafajshëm të këtij vendi, të cilëve lufta ua këputi jetën ende pa e nisur mirë. Ndonjëri prej tyre sot do të mund të ishte deputet, sepse ishte në moshën e shumë prej neve. Do të mund të ishte përfaqësues i popullit në Kuvend. Prandaj, le t'ua kushtojnë atyre një ulëse dhe t'i vendosim ata në qendër të kësaj salle, sepse ata janë epiqendra e sakrificës së popullit tonë dhe t'i mbajnë në qendër të vëmendjes sot e përherë. Kjo ulëse do të ishte thirrje e përhershme dhe reflektim për të gjithë ne që flasim nga kjo foltore, sot e kurdo, që ta kthejmë vëmendjen kah ta, ta mbajmë të freskët kujtimin për ta, e të punojmë sa duhet e si duhet për gjeneratat e ardhshme.

Të nderuar deputetë,

Ne sivjet e festuam ditëlindjen e 12-të të Republikës. Por, ndërsa po i numërojmë përvjetorët e lindjes dhe të rritës së Republikës sonë, ora e këtyre 1 133 fëmijëve të vrarë është ndalur. Distanca mes moshës së tyre e moshës së Republikës po rritet, siç po rritet edhe zbrazëtia që kanë lënë ata në familjet e tyre dhe në gjithë vendin. Fytyrat e tyre janë thirrje e përhershme për ne. Fytyrat e tyre janë thirrje e përhershme për drejtësi. Ata do të na rrinë përballë e do të na flasin çdo ditë. Së bashku me plagën e mbetur akoma të hapur: të pagjeturit.

Të nderuar deputetë,

Historia nuk do të na falë nëse ne nuk bëjmë përpjekje të hapim një faqe apo një kapitull të ri, pa e lexuar e rilexuar me kujdes faqen e së djeshmes dhe të sotmes dhe prej saj të nxjerrim mesazhet dhe qëndrimet e duhura për të ardhmen tonë dhe të fëmijëve tanë.

Zoti i bekoftë familjet tuaja!
Zoti i bekoftë miqtë e Kosovës!
Zoti e bekoftë Republikën tonë!
Ju faleminderit!

* * *

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,
Më lejoni të ju njoftoj që si Kuvend i Republikës kemi pranuar shumë mesazhe urimi, edhe në formë të shkruar, edhe në formë të videove. Edhe pse pandemia e ka pamundësuar që miqtë tanë historikë të jenë të pranishëm fizikisht, ata sot do të jenë në mesin tonë nëpërmjet disa videove. Në nderim të Ditës së Çlirimit dhe duke respektuar gjithë popullin e Kosovës, në vazhdim ju ftoj të ndjekim bashkërisht mesazhet e urimit për 21-vjetorin e çlirimit nga miqtë tanë të cilët na u gjendën në ditët tona më të vështira. Do t'i dëgjojmë urimet nga senatori Bob Dole, njëri ndër përkrahësit më të fuqishëm të Kosovës, nga lordi George Robertson, ish-ministër i Mbrojtjes në Mbretërinë e Bashkuar, nga zoti Massimo D'Alema, që ishte kryeministër i Italisë në kohën e bombardimeve të NATO-s, si dhe në fund nga komandani i KFOR-it në Republikën e Kosovës, gjenerali Michele Risi.

(Deputetët ndoqën video-mesazhet nga personalitetet e njohura ndërkombëtare: ish-senatori amerikan Bob Dole, ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s George Robertson, ish-kryeministri italian Massimo D'Alema dhe komandanti i KFOR-it, Michele Risi.)

KRYETARJA: Të nderuar të pranishëm,
Kemi marrë mesazhe me shkrim edhe nga shumë miq të tjerë, gjenerali Majk Xhekson, si dhe miq nga e gjithë bota. Ju lus që me një duartrokitje t'i falënderojmë të gjithë ata që na u gjendën, jo vetëm sot, por në këto 21 vite.

(Duartrokitje)

Të nderuar të pranishëm,
Ju falënderoj shumë për pjesëmarrje dhe me kaq i përmyll punimet e kësaj seance solemne. Në fund, dua të ju ftoj që bashkërisht të dalim në oborrin e Kuvendit të Kosovës dhe t'i mbjellim lulet kushtuar 1 133 fëmijëve të vrarë në luftën e fundit në Kosovë. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*